



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 27 mars 2025

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10:00

Në mungesë z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës mbledhjen e hapi dhe e kryesoi znj. Marigona Lahu-Nënkryetare e Komunës.

Në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e KKSB-së: z. Bashkim Bajrami, komandant i Stacionit të Policisë; z. Shefki Selmani, përfaqësues i Kishës Protestante-Podujevë; z. Xhafer Ademi, kryesues i Komitetit për Komunitete dhe përfaqësues i komunitetit rom; z. Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Bahri Selimi, përfaqësues i Emergjencave Civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim; z. Shemsi Jashari, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa munguan: z. Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj. Sevdije Mustafa, përfaqësuese e komunitetit egjiptian; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Nazif Sheqa, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit-Podujevë; znj. Ilirianë Bunjaku, përfaqësuese e FSK-së.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesit e FSK-së (Në vend të znj. Ilirianë Bunjaku, përfaqësuese e FSK-së); z. Dardan Duraku MPB/DSB; Përfaqësuesit e KFOR-it znj. Kucsera Aniko LMT, z. Karoly Kovacs dhe përkthyesi i KFOR-it Asdren Llugaliu, si dhe znj. Arianita Rraci – UNMIK.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, të respektuar anëtarë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë të KKSB në vitin 2025. Ju informoj se në mungesë të Kryetarit të Komunës për shkak të angazhimeve këtë mbledhje e kryesoj unë. Materialet për mbledhje konsideroj se i keni marrë të gjithë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës

Pas votimit Rendi i ditës u miratua njëzëri.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e ndërprerë më 12 dhjetor 2024, e vazhduar më datë 24.12.2024.

U miratua njëzëri

**2. -Informatë e Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë
-Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë**

-Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

znj. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi, fillimisht fjalën ia kalojmë Komandantit të Stacionit të Policisë z. Bashkim Bajrami.

z. Bashkim Bajrami, theksoi, situata e përgjithshme e sigurisë në zonën tonë të përgjegjësisë, është e qetë dhe stabile, pa ndonjë indikacion për përkeqësim të saj. Ka pasur numër të konsiderueshëm të rasteve të ndryshme të raportuara, por të cilat nuk kanë ndikuar në përkeqësimin e situatës së përgjithshme. Fokusi ynë gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë siguri i një ambienti të qetë për të gjithë qytetarët, parandalimi i kryerjes së veprave të ndryshme kriminale, arrestimi i personave që kanë kryer vepra të ndryshme, apo kanë rënë ndesh me ligjin. Për të realizuar detyrat tona të përditshme në ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike, kemi planifikuar dhe organizuar plane të ndryshme operative qoftë në parandalim të aksidenteve të trafikut apo parandalimin dhe zbulimin e veprave të ndryshme penale. Në këtë periudhë kohore janë mbajtur zgjedhjet parlamentare për Kuvendin e Republikës me 09 shkurt dhe nga aspekti i sigurisë e kemi mbuluar këtë ngjarje me Plan Operativ dhe gjithçka ka shkuar në rregull, për çka falënderojë gjithë policët për punën profesionale që kanë bërë, Zyrën Komunale të KQZ, të gjithë akterët tjerë të përfshirë në këtë proces.

Në aspektin e krijimit të një mjedisi më të qetë dhe ofrimit të sigurisë për qytetarët ne kemi në implementim strategjinë Policia në Bashkësi dhe Policia e Udhëhequr nga Inteligjenca që nënkupton: Rritja e patrullimeve cilësore në Sektorë si dhe prezencës policore duke u angazhuar në pika kontrolli, patrullime në këmbë, patrullime në vende të frekuentuara, patrullime në afërsi të institucioneve arsimore; Organizimi, implementimi i projekteve të përbashkëta me forumet e sigurisë KLSP, ESVB; Organizimi i takimeve me përfaqësues të fshatrave; Organizimi i takimeve me komunitetin kulturor, bizneset; Organizimi i takimeve me kompanitë private të sigurimit fizik; Organizimi i takimeve periodike me DKA-në; Organizimi i debateve, tryezave, ligjëratave si dhe fushatave vetëdijësuese lidhur me dukurit negative, aktivitete këto të cilat zyrtarët tanë i kryejnë thuajse çdo ditë.

Gjatë kësaj periudhe kohore është punuar në implementimin e Planeve operative siç janë: Kontrolli i Shtuar i Trafikut në Qytet; Parandalimi, reagimi dhe hetimi i veprave penale kundër jetës dhe trupit; Parandalimi, luftimi i degradimit dhe shkatërrimit të mjedisit në RKS; Gatishmëria vepruese-për kërcënimin me bomba; Lëmoshëkërkuesit në Rrugë; Unaza e Çeliktë; Kulti Fetar; Siguria në Shkolla; Parandalimi i veprave penale Vjedhje, Vjedhje rëndë dhe Grabitje; Ngritja e vigjilencës dhe shtimi i masave të sigurisë në Republikën e Kosovës; Sezona verore 2025; Realizimi i urdhërësive të gjykatës. Sa i përket planit operativ Siguria në shkolla kemi një bashkëpunim të mirë me DKA-në me të cilët kemi bërë plane të ndryshme për të parandaluar veprimtari të ndryshme që kanë qenë në kundërshtim me ligjin. Nga njësitë e zyrtarëve policorë që operojnë në afërsi të shkollave, kemi takime të rregullta me drejtorë dhe përfaqësues të shkollave, nga të cilët informohemi lidhur me situatën e përgjithshme brenda ambienteve të tyre. Njësitë tona mbajnë ligjërata në vazhdimësi në shkolla. Ligjëratat janë prituri mirë, si nga nxënësit, po ashtu edhe nga personeli arsimor i shkollave. Deri më tani nga takimi i fundit janë mbajtur 45 ligjërata me gjithsej 3683 pjesëmarrës, me temat: Përdorimi i internetit dhe pasojat ligjore; Bulizmi dhe masat parandaluese. Ligjëratat janë mbajtur me nxënësit nga klasat e -VI- deri te klasat e -XII-ta.

Gjatë muajit Prill 2025, me DKA-në, janë planifikuar që të mbahen ligjëratat me temat: Ruajtja e ambientit dhe trashëgimisë kulturore me klasat -I- e deri ta klasat -IX-ta dhe Siguria e qarkullimit të këmbësorëve”, me klasat -I- e deri te klasat -IX-ta.

Gjatë kësaj periudhe kohore, nga njësitë e Sektorëve, janë mbajtur dy takime me DKA-në në Komunën e Podujevës. Po ashtu, me datë 02.04.2025 është paraparë takimi i përbashkët me DKA-në, Drejtorët e shkollave dhe me përfaqësuesit e prindërve. Nga rastet që i kemi trajtuar nga Njësia jonë nëpër shkolla janë: 3- mbajtje në kontroll posedim i paautorizuar i armëve, 2 - Sulm; 1- Lëndim

i rëndë trupor;1- Kanosje;1 –Vjedhje. Gjatë këtyre rasteve janë konfiskuar :2 mjete të mprehta thika; 1 boks i hekurit;7 persona janë arrestuar, 5 prej të cilëve janë dërguar në mbajtje.

Rastet më të rëndësishme në kuadër luftimit të dukurive negative shoqërore siq janë :Kafiteritë e natës, Organizimi i skemave piramidale dhe bixhozi të kundërligjshëm, ne kemi pasur angazhime në këtë drejtim dhe si nga informacionet tona po ashtu kemi pranuar edhe ankesa edhe nga familjarët për të afërmit e tyre që merren me këto dukuri. Në këtë aspekt kemi bërë plane dhe kemi trajtuar 7 raste, kemi arrestuar 4 persona, 2004 euro të konfiskuara,6 shtëpiza ,1 laptop, 2 skanerë dhe 3 printerë.

Nga rastet tjera si Posedim i paautorizuar i substancave narkotike kemi trajtuar: 25 raste,1 person të arrestuar, 3 kontrole të shtëpive, Janë konfiskuar 2262 gram substancë narkotike duke filluar nga 0.34 deri në 132 gram te persona të caktuar.

Gjatë kësaj periudhe kemi konfiskuar 27 armë dhe 321 copë fishekë. Nga raste e trajtimit të vjedhjeve, kemi 38 vjedhje , vjedhje të rënda 32 Po ashtu janë trajtuar edhe 30 raste të dhunës në familje.

Nga incidentet e zjarrit gjatë kësaj periudhe kohore, janë raportuar gjithsej 24 raste të zjarrvënieve, prej tyre: Raste të hapura - 01 – një person i dyshuar; Raste të mbuluara me shënime zyrtare - 06; Raste të mbuluara me raport polici-17.

Nga urdhëresat, prej tyre kemi të realizuara 65, prej tyre 52 me gjobë dhe 13 me burg.

Nga aspekti i sigurisë në trafik kemi trajtuar: Aksidente me dëme materiale - 97; Aksidente me persona të lënduar – 39; Mos ndalje në vendin e ngjarjes - 35.

Sipas statistikave nga data 01/12/2024 deri me datën 25/03/2025 janë shqiptuar gjithsej 3341 tiketa trafiku.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi e hap diskutimin për informatën e paraqitur nga Komandanti i Stacionit të Policisë.

z. Shefki Selmani, theksoi, nuk jam në dijeni se kjo kujt duhet adresuar si pyetje, por kërkesën e kam për vendosjen e kamerave në rrugën “Skënderbeu”, sepse po vërehet se nuk ka aktivitete të rastësishme, gjithashtu kërkesa është që të ketë lëvizje më të frekuentuar të Policisë në atë rrugë, për arsye të vozitjes shumë shpejtë të votuarave dhe nuk jam në dijeni a është ndonjë masë parandaluese, për vendosje të ndonjë pengese. Mendoj se duhet të merren masa urgjente, në veçanti për kamerat e sigurisë në atë rrugë.

z. Shemsi Jashari, theksoi, dëgjuam raportin e Komandantit të Policisë dhe pamë që ka një aktivitet të zhvilluar bukur të madh dhe të rezultateve të punës. Duke pas parasysh se kohën e fundit jemi tronditur me shumë raste të vrasjeve, ku më të goditurat janë Kryeqyteti dhe Komuna e Vushtrrisë, një pyetje kam për Komandantin, a kemi ndonjë shtesë që vjen si kërkesë nga Niveli qendror , si rezultat dhe nevojë e shtimit të aktivitetit për shkak të rasteve të fundit, apo jemi vetëm në nivelin operativ që është i zakonshëm të cilin Policia ka mandat ta bëjë dhe që është duke e bërë mirë.

z. Nuhi Selimi, theksoi, sikurse jeni në dijeni në Komunë veprojnë dy KLSP të cilat janë duke bërë përpjekje për ushtrimin e funksionit që kanë. Në mbledhjet e KKS-së zakonisht parashtrihen kërkesa nga qytetarët për çështje të sigurisë. Në mbledhjen që e mbajtëm dje u parashtruan kërkesa të njëjta si çështje problematike të cilat janë paraqitur disa herë. Pra kërkesa ime është që mundësisht të informohen në rend të parë për kamera të sigurisë për vendosje nga penda deri në Orllan, a është ndërmarrë diçka, pastaj çështja e trotuarit te ura në Orllan që është çështje shumë e ndejshme dhe është një kërkesë e kamotshme, nuk është e sotit dhe nuk jam në dijeni se a është duke u marrë dikush me këtë punë. Është po ashtu një kërkesë tjetër që është bërë që moti për vendosje të pengesave në rrugë, sikurse ato me vibrime, ngjashëm që janë vendosur në 6-7 vende nga fshati Lluzhan deri në fshatin Batllavë. Edhe në fshatin Orllan është e nevojshme të vendosen 2-3 pengesa të tilla pran shkollës dhe e tëra kjo vetëm për çështje të sigurisë. Pra dua të jem në dijeni se a pritet diçka të bëhet ose ta lejmë e mos të flasim fare më për këtë çështje.

znj. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi, fjalën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z. Bashkim Majrami.

z. Bashkim Bajrami, theksoi, sa i përket rrugës “Skënderbeu” keni pika kontrolli të caktuara dhe kemi Njësinë e angazhuar të Shkollës “Ibrahim Rugova”, mirëpo sa i përket këtyre dukurive negative, kurdo që has secili qytetar duhet raportuar dhe këtë e ka edhe obligim ligjor, sepse janë organet që merren me to dhe i trajtojmë këto informata. Sa i përket kamerave ato janë funksionale dhe në vazhdimësi merremi me to dhe për këtë kemi bashkëpunim të rregullt me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe intervenohet aty ku paraqitet nevoja sepse ka edhe probleme teknike të funksionimit. Ne kemi 12 Plane operative aktive dhe punohet çdo ditë në implementimin e tyre, por mbajmë angazhime shtesë edhe sa i përket regjionit, shkëmbejmë informacione për dukuritë e tilla dhe normal i autorizojmë zyrtarët policor për veprime në terren. Sa i përket pyetjeve dhe kërkesave nga mbledhjet e KLSP-ve, këto trupa janë funksionale dhe nga ato takime dalin kërkesa drejtuar Drejtorive dhe shërbimeve komunale por edhe ndaj Policisë. Në bazë të ankesave dhe kërkesave të qytetarëve ne përgatisim shkresa dhe i përcjellim ato. Sa i përket pengesave është fakt se janë vendosur në fshatrat Llugë dhe Batllavë pasi që ka pas aksidente në ato akse rrugore, dhe për këtë arsye ka qenë tërheqje e vëmendjes shtetërore prandaj edhe janë vendosë. Ju bëni kërkesën për pjesën e Orllanit dhe ne do ta procedojmë te autoritetet.

znj. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, fjalën e ka Drejtori i DSHPMSh z. Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, theksoi, ishin disa pyetje që iu drejtuan Komandantit të Stacionit të Policisë, por në fakt kanë të bëjnë me DSHPMSh dhe dua të jap përgjigje në ato që bien në përgjegjësi të Drejtorisë. Kamerat e sigurisë është e vërtetë që kontrollohen dhe menaxhohen nga Policia e Kosovës, mirëpo zgjerimi i rrjetit dhe mirëmbajtja e tyre bëhet nga DSHPMSh. Në këtë kontekst ishte një pyetje për rrugën “Skënderbeu”, unë e di se kjo rrugë ka mbulueshmërinë me kamera të sigurisë, dhe për të qenë më konkret vitin e kaluar mbulueshmërinë e kësaj rruge e kemi realizuar dhe gradualisht jemi duke shkuar në zgjerimin e rrjetit, mirëpo sigurisht se prioritet e kemi qytetin dhe atë në pjesët më të frekuentuara, e pastaj sigurisht do të bëhet shtrirja edhe në Orllan por jo së shpejti, sepse ende kemi pjesë të qytetit ku nuk i kemi të mbuluara me kamera. Me kontratën e fundit të lidhur vitin e kaluar, thuajse pjesa dërmuese e qytetit është e mbuluar me kamera. Po ashtu këtë vit jemi në procedurë të lidhjes së një kontrate të re ku kemi edhe mirëmbajtje por edhe zgjerim të rrjetit të kamerave në tërë qytetin. Pra mund të thuhet se mbulueshmëria me kamera nuk qëndron keq edhe pse ne nuk i menaxhojmë. Për trotuarin në fshatin Orllan te ura, këtë e kemi marrë si kërkesë me prioritet. Këtë vit kemi ndarë buxhet për ndërtimin e atij trotuari dhe tashmë jemi në procedurë të projektimit dhe është një projekt fillestar i urës, ku parashihet edhe trotuari ku do të kalojë përgjatë urës me gjatësi prej 320 m. Mirëpo kostoja e projektit është shumë e lartë, ku sipas projektuesve kap vlerën rreth 200,000 €. Kjo është shumë e madhe duke marrë parasysh specifikat e ndërtimit të trotuarit në atë rrugë. Besoj se këtë vit do të realizohet ky projekt.

Sa i përket kërkesës për vendosje të pengesave në rrugë, sa për sqarim rruga Lluzhan – Orllan është rrugë regjionale dhe menaxhohet nga Ministria dhe të gjitha ato pengesa i ka vendosur Ministria, mirëpo ne kemi bërë kërkesa për disa vende, por i kanë vendos pengesat ku ata kanë vlerësuar se rrezikshmëria është më e madhe. Ne nuk jemi kompetent dhe nuk kemi të drejtë për të vendosur pengesa në rrugë regjionale. E tëra çka mund të bëjmë ne është të përcjellim kërkesat në Ministri, dhe ata kanë komisionin përkatës që del në terren dhe bën vlerësimin për vendosje apo mos vendosje të pengesave në këtë rrugë.

znj. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi, kalojmë te informata e përfaqësuesit të KFOR-it. Fjalën e përfaqësuesi i KFOR-it.

Përfaqësuesi i KFOR-it, theksoi, përshëndetje zonja dhe zotërinj, ju falënderoj për ftesën. Ju përkujtoj se KFOR-i në Kosovë kryen mandatin sipas Rezolutës së Kombeve të Bashkuara, gjithashtu në bashkëpunim me faktorët relevant për çështje të sigurisë publike këtu, si Policinë e Kosovës dhe EULEX-in. Policia e Kosovës është si reaguesi i parë sipas nevojës, Eulex-i është

reaguesi i dytë, ndërsa KFOR-i është reaguesi i tretë. Mandati ynë është të sigurojmë një ambient të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës pa marrë parasysh etninë, përcaktimin fetar, gjuhën apo racën. Kjo është e tëra nga ne, nëse keni ndonjë çështje lirisht mund ta parashtroni.

znj. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi, falënderojmë përfaqësuesin e KFOR-it për informatën, e hap diskutimin lidhur me këtë. Nëse nuk ka të interesuar fjalën ia kalojmë përfaqësuesit të FSK-së.

Përfaqësuesi i FSK-së, theksoi, sa i përket aspektit të sigurisë nga ana e FSK-së vlerësohet situatë e qetë dhe stabile. FSK është duke vepruar në Kazermën e re në fshatin Dumosh e cila është nën ombrellën e FSK-së. Një sukses i radhës është edhe marrja e 100 ha tokë mbi Liqenin e Batllavës, në të cilën hapësirë po punohet në rregullimin e mirëqenies. Gjithashtu kjo hapësirë do të shfrytëzohet nga FSK për trajnime të ndryshme për të cilat do të njoftoheni me kohë. Kjo ishte e tëra.

znj. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi e hap diskutimin. Nëse nuk ka të interesuar rreth lidhur me informatën kalojmë në pikën e radhës sipas të rendit të ditës.

3. Informatë për punën dhe aktivitetet e KKSBB-së për vitin 2024

znj. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi fillimisht fjalën ia kalojmë kryesuesit të grupit punues për përgatitjen e informatës z. Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit.

z. Avni Fetahu, theksoi, të nderuar anëtar të KKSBB-së, keni materialin e draft Informatës për punën dhe aktivitetet e KKSBB-së për vitin 2024, përkatësisht një përmbledhje prej procesverbaleve të detajuara, çka kemi diskutuar për punët në vitin 2024. Kërkojmë ndjesë për disa gabime teknike që duhet përmirësuar që kanë ndodhë te paragrafi i parë, përndryshe informata është e zgjeruar dhe jemi të hapur për diskutim nëse dikush ka për të shtuar apo për të hequr diçka.

znj. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi, a ka dikush diçka për të shtuar rreth kësaj informate.

z. Shemsi Jashari, theksoi, rreth raportit apo informatës për punën që ne e kemi bërë kam dy pyetje; e para pse si informatë nuk po hartohet në formën e informatës, po thjeshtë janë copy paste prej procesverbaleve dhe kështu del një raport pak i gjatë me fjalë për fjalë çka kemi folur gjatë tërë vitit, e që është edhe pak e mundimshme edhe pak e paqartë. E dyta, e shoh se ka shumë material dhe nuk e di se anëtarët e KKSBB-së sa kanë mundur ta lexojnë mirë dhe ta kuptojnë se çka kemi bërë, pyetja është se a ka mundësi në pika të shkurtra të na tregoni vetëm për aktivitetet e KKSBB- të kryera në vitin e kaluar. Pasi që jeni marrë me të besoj se keni pas rast t'i shihni më mirë.

z. Avi Fetahu, theksoi, po ke të drejtë plotësisht se informata do duhej të jetë më e shkoqitur pak për tua lehtësuar punën edhe juve, por edhe ne ishim mes presionit të asaj se kur po i shkëputet një pjesë e informatës mund ti humb nganjëherë edhe kuptimi, sepse si dokument është e nevojshme ti japim qëllimin, objektivat e saj etj, dhe i kemi ikur asaj në mënyrë për të qenë sa më transparent dhe të jetë gjithë përfshirja e tërë asaj që është diskutuar dhe në këtë kontekst e pamë të arsyeshme të bartim procesverbalet për secilën pikë, e që aty kemi gjashtë takime dhe secila prej tyre pasqyron situatën e caktuar për çka edhe është diskutuar. Përndryshe kjo të jetë një këshillë apo sugjerim apo mund të thuhet edhe vërejtje që herave tjera si dokument të jetë më e shkoqitur dhe më e qartë.

z. Shemsi Jashari, theksoi, pyetja ishte se a kemi pas ndonjë aktivitet ne si KKSBB, sepse ka kaluar një kohë dhe mund të harrohen, pra na intereson të dimë se cilat janë ato aktivitete, sepse unë nuk jam në dijeni dhe jam i interesuar që të informohem dhe të konstatohet me procesverbal se a ka pas aktivitete dhe nëse po cilat janë. Përveç mbledhjeve të rregullta të cilat i kemi mbajtur, s,po flas për punët që i keni në kuadër të Drejtorive sepse janë obligime të juaja, si KKSBB, cili është aktiviteti që kemi kryer në vitin e kaluar.

z. Avni Fetahu, theksoi, konsideroj se ne si Këshill i kemi mbajtur të gjitha aktivitetet, përjashtimisht një aktiviteti që e kemi caktuar ta mbajmë në natyrë lidhur me mbrojtjen e ambientit, ndërsa e kemi mbajtur këtu, pra se kemi mbajtur në natyrë, kështu që nuk kemi pas ndonjë aktivitet

të veçantë që e kemi pas të planifikuar dhe që nuk është realizuar, të paktën në bazë të Planit të punës që e kemi sjellë këtu në fillim vit.

z. Shemsi Jashari, theksoi, pa dashur për të reflektuar për të polemizuar me ty, unë e kuptoj pozicionin e drejtorit, por duhet me qenë të sinqertë sepse po flasim brenda Këshillit. Ne të gjithë jemi në dijeni sepse mundemi ta pohojmë apo ta mohojmë, por asnjë aktivitet si KKSBB-së nuk është mbajtur. Për ta pasur të qartë kemi pas të planifikuar takime me akterë të nivelit komunal ku do të diskutoheshin tema që kanë të bëjnë me sigurinë. Plani është publik por që asnjëra prej tyre nuk është realizuar. Këtë nuk e them ta kritikoj Drejtorin por komplet KKSBB-në, sepse jemi duke ardhur kot këtu. Raportin që dëgjuam prej Komandantit të Policisë e dëgjojmë raportin 24 orësh, informatat konfidenciale edhe ashtu s'kanë të drejtë ti paraqesin. Kjo është shndërruar në një rutinë për të ardhur këtu dhe për tu kthyer pa bërë asgjë. Unë qëllimisht parashtrova këtë pyetje duke ditur përgjigjen se ne si KKSBB dhe ju si Komunë që keni përgjegjësi për të drejtuar, prej 33 milion euro sa ka Komuna buxhet vjetor mund t'i ndani fjala vjen 500 euro për të organizuar një takim, mbajtjen e një tryeze pune, fjala vjen për pagesën e ujit të pijes dhe për të biseduar me akterë për çështje të sigurisë. Për çështjet e sigurisë, rastet që janë duke ndodhur e kanë të bëjnë me sigurinë nuk është imun as Podujeva, kemi pas vitin e kaluar rastet e të rinjve të involvuar, e tashmë po i ndodhë Prishtinës, Vushtrrisë, e nesër mund të na ndodhë edhe neve, e që këto tema është dashur ti diskutojmë më shumë dhe më mirë. Mendoj që Komuna është dashur ta marr më seriozisht këtë Këshill, sepse unë besoj se ka punë shumë më të rëndësishme se sa në mënyrën qysh po trajtohet. Përndryshe mungesa e Kryetarit, me gjithë respektin për Nënkryetaren, me qenë i sinqertë është një energji më pozitive brenda sallës kur mungon Kryetari, por injorimi që ai është duke i bërë këtij këshilli nuk është i mirë, nuk është i shëndetshëm. Ai duhet t'i kuptojë përgjegjësitë e veta, e njëjta po ndodhë edhe me mbledhjet e Kuvendit komunal, nuk jam në dijeni ku e ka hallin Kryetari, por edhe ashtu nuk i ka mbetur mandat shumë, nëse është lodhur, por të paktën të qëndroj edhe këta 3-4 muaj sa i kanë mbetur, por le të vjen në këto takime. Nëse i referohesh procesverbaleve rezulton se ma shumë nuk ka qenë në këto mbledhje se sa që ka marrë pjesë.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, unë e ceka që në fillim të mbledhjes se zëvendësimi është bërë për shkak të angazhimeve që ka Kryetari dhe nuk ka ndonjë qëllim. Te çështja e sigurisë është diçka që na prek të gjithëve dhe është interes i të gjithë neve. Nëse nuk ka dikush diçka tjetër për të shtuar rreth kësaj teme kalojmë në pikën e radhës.

4. Të ndryshme

z. Dardan Duraku, zyrtar i Divizionit për Siguri në Bashkësi-MPB, theksoi, dua të shfrytëzoj rastin të falënderoj KKSBB-në në Komunën e Podujevës. MPB gjatë vitit 2024 ka hartuar një raport për funksionimin dhe adresimin e shqetësimeve të ndryshme që kanë dal nga KKSBB, dhe mund të themi dhe njëkohësisht e përgëzojmë Komunën e Podujevës pasi që ka qenë njëra prej komunave më aktive në adresimin e shqetësimit të qytetarëve në bazë të procesverbaleve të cilat i kemi pranuar nga ky Këshill, pra ka dalë Komuna më aktivja në këtë aspekt. Ka qenë prej Komunave që ka mbajtur takime të rregullta. Në bazë të Raportit kanë rezultuar mbi 50 shqetësime, si më të theksuara janë ato në shkollë, në trafik, përdorimi substancave narkotike etj. Sigurisht edhe Komuna e juaj ballafaqohet me këto shqetësime, sepse secilin vit po na ndodhin dukuri negative kështu që edhe ndihma është e domosdoshme si nga niveli qendror po ashtu edhe nga niveli komunal. Për bashkëpunim nuk hezitojmë për eliminimin e këtyre dukurive negative. Urime për punën e mbarë.

z. Shemsi Jashari, theksoi, një pyetje për zyrtarin nga MPB nëse ka ndonjë raport të përmbledhur, nëse nuk është konfidencial a ka mundësi të na shpërndani neve si anëtar të KKSBB-së, ndoshta do të kishte për të na shërbyer duke parë edhe praktikën e të tjerëve si kanë vepruar.

z. Dardan Duraku, zyrtar i Divizionit për Siguri në Bashkësi-MPB, theksoi, Raporti është hartuar, është në proces të përcjelljes edhe në Nivel qendror, dhe më pastaj besoj se do të jetë publik edhe në ueb faqen e Ministrisë.

z. Qefser Behrami, theksoi, më datë 25.03.2025 KLSP-së –Orllan mbajti mbledhje në të cilin këshill përfaqësohen 34 fshatra dhe prezent thaujse ishin 60-70% përfaqësues të këtyre fshatrave. Në takim u bisedua gjatë për çështje të sigurisë. Nga ky takim kam tri kërkesa të paraqitura nga përfaqësuesit e fshatrave, dhe atë; përfaqësuesi i fshatit Llaushë ka theksuar se është kohë e gjatë që kur kam parashtruar kërkesë për mbylljen e një pusi një pjesën e epërme të fshatit që është shumë i thellë dhe i gjerë dhe i cili paraqet shumë rrezik për kalimtarët e rastit sidomos gjatë natës, gjë që mund të vije deri te ndonjë fatkeqësi shumë e madhe. Pra ai ka theksuar se kam bërë kërkesë në Komunë por i kanë thënë se duhet të ketë termin për në Komunë. Kërkesa tjetër është nga përfaqësuesi i fshatit Dumnicë e Poshtme për ta siguruar një vijë transportit për bartjen e nxënësve. Dhe nën tre, përfaqësuesi i fshatit Metehi ka cekë disa kërkesa, ndër tjera theksoi është një rrugë lidhëse me fshatin Metehi – Dobërdol dhe qytetin e Podujevës. Ajo ka qenë rrugë autoktone dhe para rrugës aktuale për në fshatin Pollatë. Pra kjo që po flas ka mbetur rrugë dytësore, por sido që të jetë është e nevojshme të rregullohet sepse si shkak i rrugës kanë mbetur shume ara pa i punuar pasi që nuk është e mundur të kalojë kombajnmat për korrje shirjet. Pastaj është edhe një sipërfaqe tokësore që jep rendimentet më të larta në fshatin Metehi ku edhe unë i përkas, prej rreth një hektar, e cila ka mbetur pa u punuar për shkak të fatkeqësive natyrore, konkretisht vërshimeve. Këtu duhet ndërmarrë diçka për rregullimin e një muri mbrojtës, është kërkesë e kamotshme. Pse diku po ka mundësi të punohet e investohet ndërsa këtu jo. Kjo është kërkesë e komunitetit, jo e imja personale.

z. Bahri Selimi, theksoi, kërkesat e paraqitura realisht kanë të bëjnë edhe me sigurinë. Sa i përket pusit në fshatin Llaushë, deri më tani në Drejtorinë e Shërbimeve Publike nuk ka pas një kërkesë të tillë edhe pse u theksua nga parafolësi, por megjithatë do të interesohem edhe pa kërkesë, do të dalim në terren dhe do të përcaktojmë rrezikshmërinë e pusit, zyrtarët për emergjencë janë kompetent për këtë çështje. Për mungesën e transportit në fshatin Dumnicë, kjo është kërkesë apo mund të themi edhe ankesë e kamotshme. Transporti është ndërprerë për shkak të mungesës së udhëtarëve. Ne si autoritet komunal çdo vit i japim leje një operatori privat për të mbajtur këtë linjë në relacion Podujevë-Dumnicë, mirëpo në mungesë të udhëtarëve ai operator privat nuk shkon, ndërsa ne si autoritet komunal nuk mundemi ta detyrojmë të shkoj. E tëra çka ne mund të bëjmë si Drejtori nëse ai nuk i përmbahet lejes që ne i kemi dhënë paraprakisht është ti revokojmë lejen, atëherë çfarë është interesi i jonë për revokimin e lejes. Ne duhet insistuar ta detyrojmë atë për bartjen e udhëtarëve, sepse kërkesa e udhëtarëve është për sigurimin e transportit të tyre, pra nuk kanë probleme me operatorin por probleme me mungesën e autobusit në këtë linjë. Ne jemi duke punuar në këtë drejtim por nuk do të thotë se do të zgjidhet shpejt. Unë kam biseduar shumë herë me banorë të fshatit Dumnicë dhe u kam thënë që të gjejnë transportuesin e tyre, por që i njëjti i plotëson kushtet ligjore, ndërsa unë do ta pajis me leje, vetëm e vetëm të mos mbesin udhëtarët pa transport, por edhe ata nuk kanë mundur ta gjejnë. Pra qëllimi ishte që të pajisim me leje atë transportues që e përzgjedhin banorët, ndërsa njëkohësisht atij aktual t'i revokonim lejen nëse nuk kryen transportin e udhëtarëve, pasi që kjo çështje është e rregulluar me ligj. Sa i përket rrugës në relacionin Metehi-Dobërdol, nëse po flas për rrugën e njëjtë tash me projekt është një rrugë që lidh fshatin Kërpimëh dhe nuk jam në dijeni se a lidhet edhe fshati Metehi në këtë rrugë, kjo është kontratë që do të trajtohet vetëm me zhavorr dhe së shpejti pritët fillimi i punimeve. Për murin mbrojtës të lumit të ura, ju kam treguar edhe herën e fundit se jemi në pritje të një kontrate për projektimin e lumenjve, dhe pa u bërë projekti nuk kemi mundësi të intervenojmë askund në lumenj, për shkak se nuk mund të lidhim dy apo tri kontratat brenda vitit. Fillimisht është ende në procedurë kontrata për projektim dhe pas projektimit besoj që me ndihmën dhe me buxhetin që ka ndarë Ministria që tashmë është 4 milion dhe një pjesë e jona buxhetore do të bëhen shumë punë në shtretërit e lumenjve, por e përsëris pa u bërë projekti nuk mund të intervenojmë askund. E presim njëherë projektin pastaj fillojmë

procedurat për një kontratë për rregullim të shtretërve të lumenjve në tërë territorin e Komunës së Podujevës.

z. Qefser Behrami, theksoi, përfaqësuesit e fshatrave kanë kërkuar që kur të mbajmë një mbledhje të KLSP-së të jenë prezentë edhe disa inspektorë kompetent për të dëgjuar kërkesat e tyre. Sa i përket çështjes së lumit mbrojtës ka tre vite kohë, dhe të mos ekzistojë mundësia për ta rregulluar nuk e di se çka është problemi. Ne jemi dëshmitarë se ku punohet dhe çka punohet.

z. Shefki Selmani, theksoi, pyetja ime është më shumë rreth transportit publik, si është situata me autobusë. Stacioni i autobusëve është ndërtuar, por kjo po ndërlihet drejtpërdrejtë me udhëtarët që po udhëtojnë për në Prishtinë, dhe si rrjedhojë për shkak të pakënaqësive ishte një pauzë apo pezullim. Pyetja është se a ka ndonjë metodë që Komuna e Podujevës mund të sigurojë transport për qytetarët që shkojnë në punë, nëse potencialisht kjo ndodhë prapë. Ne kemi parë se shumë qytetarë kanë paguar prej 5-10 euro transport për të shkuar në punë çdo mëngjes dhe ka pas ankesa të shumta nga ana qytetarët rreth kësaj çështjeje. Nuk jam dijeni se në këtë takim a është dikush për transportin publik, sepse na intereson që të informohemi se a ka ndonjë plan për hapjen e Stacionit të autobusëve dhe a do të kemi transport publik për popullatën këtu në qytet.

z. Bahri Selimi, theksoi, po e përsëris vitin e kaluar nuk është bërë rregullim i shtretërve të lumenjve, por është bërë vetëm mirëmbajtje dhe hapje të lumenjve ku ka pas mbyllje, sepse kemi qenë në pritje të kësaj kontrate. Pa u bërë projekti i mirëfilltë për të gjithë lumenjtë ne nuk mund të veprojmë. Ne nuk kemi vetëm problem te ura e fshatit Metehi aty ku është edhe ara e z. Qefser Behrami por kemi problem në të gjithë lumenjtë e Komunës së Podujevës, prandaj jemi në pritje të përgatisim një projekt të mirë. Është fat i mirë se kemi ndarë buxhet për këtë dhe po besoj se brenda këtij viti do të fillojmë me rregullim të shtretërve të lumenjve. Pyetja që i referohej transportit publik është pyetje me vend sepse kemi pas probleme të shumta me transportuesit e linjave ndër urbane, në këtë rast të cilat janë të menaxhuara nga MMPHI, mirëpo ne si autoritet komunal nuk kemi ndenjur duar kryq edhe pse çështja nuk është në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive tona, por kemi diskutuar me zyrtarë të Ministrisë dhe me zyrtarë të Komunës së Prishtinës. Komuna e Prishtinës u ka ndaluar hyrjen në qytet dhe e tëra kjo ka dal si pasojë e ndalesës së tyre të hyjnë në qytet apo për të eliminuar stacionin të Xhamia e llapit, i cili është stacion i njohur për pjesën tonë. Në fund Kryetari i Prishtinës dhe zëvendës ministri i MMPHI ka pas një takim ku bashkërisht kanë ngritur një grup punues në të cilin janë përfshirë MMPHI, Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Podujevës. Në atë grup kam qenë unë nga Komuna e Podujevës dhe në fund jemi dakorduar ku ju kemi caktuar një linjë linjave ndërrurbane në pajtueshmëri me ta, sepse në takim ka qenë edhe përfaqësuesi i shoqatës së transportuesve publik. Linja është pa hyrë në brendi të qytetit, por në periferi të tij ku ishin të pajtuar edhe transportuesit e linjave ndër urbane që tashmë janë duke operuar, pra është zgjedh ngërçi i cili kishte qenë më herët, megjithatë kjo është zgjidhje e përkohshme. Tashmë jemi duke punuar me Ministrinë për ta bërë një zgjidhje të përhershme. Komuna e Prishtinës ka politikat e veta brenda territorit të vet administrativ dhe vepron për interesa të qytetarëve të saj pa menduar se a u paraqet probleme komunave tjera sikurse na është paraqitur neve, sepse ankesat gjithherë kanë qenë prej operatorëve dhe qytetarëve të Komunës së Podujevës të cilët shkojnë në Prishtinë ku kanë edhe punën, duke ditur se çfarë frekuentimi i qytetarëve të Komunës sonë në drejtim të Prishtinës, mirëpo ne nuk mund të ndërhyjmë në politika të tyre. Është fat i mirë se kemi një Memorandum Bashkëpunimi ndërkomunal të fushave të ndryshme ku në kuadër të saj është edhe transporti apo rregullimi i komunikacionit, dhe në bazë të këtij memorandumi kemi vepruar. Tashmë kemi bërë dy kërkesa të reja në Komunën e Prishtinës për zgjatjen e linjave në fshatrat Bellopojë, Halabak, Tërnavë. Edhe pse linjat e Prishtinës kanë të drejtë të kalojnë përmes territorit të Komunës tonë nuk kanë të drejtë të marrin udhëtarë brenda territorit të Komunës tonë, andaj bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit kemi kërkuar që linja Prishtinë-Sharban të ndalet edhe në fshatrat e cekura për marrjen e udhëtarëve në vend stacionet që i kemi caktuar në bashkëpunim me banorët e asaj pjese që kanë kërkuar. Fshati Dyz është pa transport dhe ne kemi kërkuar që linja Prishtinë-Koliq të zgjatet

deri në fshatin Dyž, në mënyrë që të përfshihen edhe banorët e këtij fshatit në këtë linjë dhe për këtë të fundit jemi në pritje të përgjigjes, ndërsa për të parën kemi marrë përgjigjen menjëherë dhe tashmë autobusi i linjës së Sharbanit merr udhëtarët e tri fshatrave që ne i kemi pas të pambuluara, po flasim për udhëtarët që shkojnë në Prishtinë sepse ata që vijnë në Podujevë e kanë linjën tjetër në drejtim Halabak – Podujevë. Kjo ka qenë një temë shumë e gjerë sepse kemi pas debate të shumta me Ministrinë dhe Komunën e Prishtinës. Besoj se tashmë është problem i zgjidhur. Po ashtu kemi edhe çështjen e linjave tona urbano-periferike që jemi duke u marrë me to. Sa për informim përmes një Njoftimi publik kemi kërkuar që të gjithë operatorët e transportit të shkojnë në Stacion të autobusëve dhe nisjet dhe kthimet t'i bëjnë nga Stacioni, përdërisa itineraret dhe linjat e tyre nuk kanë ndryshuar, janë të njëjtat, por vend parkimi i tyre do të jetë Stacioni i autobusëve e jo rrugët e qytetit sikurse kanë qenë deri më tash të bllokuara prej transportuesve publik. Kjo do të zbatohet nga dita e hënë nga Inspeksioni dhe me këtë kemi njoftuar edhe Policinë. Kam parë disa keqkuptime apo keqinterpretime, por nuk do të ketë asnjë problem të udhëtarët sepse do ta kenë linjën e njëjtë vetëm se autobusi nuk do të jetë i parkuar më në rrugë por do të shkoj në stacion sepse stacioni është i ndërtuar për këtë qëllim.

z. Qefser Behrami, theksoi, desha të kyçem në diskutimin e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, sepse në një pjesë të diskutimit e përmendi, citat; ara jote, atëherë z. Drejtor nëse është ara ime mos e ndërtoni murin, por aty nuk është vetëm ara ime, e imja është në brendësi, s'është e vërtetë kjo që thua. Unë i përcjell dhe i paraqes kërkesat e banorëve të asaj pjese, përndryshe unë mund të jap edhe dorëheqje nga ky Këshill.

z. Bahri Selimi, theksoi, stacionet e asaj linje i cakton Komuna e Prishtinës, pra ajo cakton stacionet për territorin e vet deri në fshatin Lupç, Komuna e Podujevës nuk ka qasje në territorin e saj. Ajo i ka të caktuara stacionet se ku duhet ndalur autobusët. Prej fshatit Lupç deri në fshatin Halabak, pak para se të hyj në fshatin Sharban aty ku kemi përkufizim administrativ të territoreve komunale, operatorët e transportit të Komunës së Prishtinës nuk kanë të drejtë të ndalen pa dhënien e pëlqimit nga ana jonë sepse është territor i Komunës tonë, ndërsa në Sharban e ndalon prapë. Kjo është e rregulluar në baza ligjore, mirëpo ne kemi kërkuar që të ndalojnë edhe në territorin e Komunës sonë për arsye të mos mbesin udhëtarët pa transport. Ligji e përcakton qartë se kur të caktohen linjat duhet respektuar koha mbrojtëse që parasheh kohën mes dy linjave, përkatësisht autobusëve që qarkullojnë nëpër të njëjtin stacion, pra duhet respektuar koha mbrojtëse dhe ajo është primare për operatorët e cila në fakt nuk lejon apo pamundëson që të ketë konflikte apo probleme mes veti, e dyta, mbulueshmëria duhet të jetë për secilin qytetar, por jo domosdoshmërisht do të na konvenojë të gjithëve ashtu siç kemi dëshirë, fjala vjen te unë nuk ka transport fare dhe duhet qarkulluar vetëm me veturë, ky ishte vetëm një shembull, por sido që të jetë unë tregova si është procedura dhe si janë bashkëpunimet mes dy komunave kur një autobus prek territorin e dy komunave. Për territorin e vet Prishtina i cakton linjat, ndërsa unë jam vetëm i interesuar për qytetarët e Komunës së Podujevës, konkretisht për fshatrat Tërnavë, Bellopojë dhe Halabak të cilat kanë mbetur pa transport, dhe bashkërisht në këto fshatra i kemi caktuar 8 vend ndalime të autobusit të Sharbanit për marrjen e udhëtarëve.

z. Shemsi Jashari, theksoi, këtë muaj që lamë pas ka pas protesta prej operatorëve ekonomik kompanive të autobusëve, por ka pas protesta edhe prej qytetarëve pikërisht për të njëjtën temë, ka pas diskutime edhe në publik, media për mospajtimet në mes Komunës së Prishtinës dhe Komunës së Podujevës. Si qytetarë që nuk kemi qenë në ngjarje në baza ditore dhe që s'kemi qenë pjesë e atyre takimeve kur janë sqaruar, jemi të ngatërruar në informacion. Dua të them që do të ishte mirë Komuna e Podujevës të dal me një udhëzues publik për të treguar cili është versioni i fundit ku munden qytetarët të shfrytëzojnë transportin. Kjo linja e re që u tha nga Drejtori, rreth hekurudhës që të shkohet deri te Stacioni, jo të gjithë janë në dijeni se ku është, nuk kanë informacione se ku është. Udhëzuesi të jetë në formë të hartës apo të një videoje të shkurtër që i sqaron qytetarit, sepse kemi studentë dhe qytetarë në moshë të mesme e të shtyrë që nuk e kanë mundësinë ta kuptojnë drejtë dhe

saktë secilin ndryshim dhe detaj që bëhet me emra të rrugëve, fjala vjen se ku gjendet ajo rrugë, sepse janë ndërruar emrat shpesh, kështu që një udhëzues i vogël qoftë në formë broshure apo të ndonjë videoje kishte për të ndihmuar në sqarimin e këtyre paqartësive të cilat ne në këtë sallë i kemi. Jemi të thirrur për të trajtuar këto tema dhe ne po kemi paqartësi se cili është versioni i fundit që ka mbetur pas shumë diskutimeve në publik. Po besoj se nuk është mund i madh, është diçka e dakorduar, thjesht vetëm për ta vizualizuar për qytetarin që jetë i informuar, që nëse niset për Prishtinë për të qenë në dijeni se ku ndalet autobusi apo ku duhet pritur për tu kthyer këndeje.

znj. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, falënderojmë z. Shemsi për sugjerimin, a ka të tjerë që duan të marrin fjalën, nëse nuk ka të tjerë të interesuar e përmbylli takimin dhe ju falënderoj për pjesëmarrjen, sugjerimet e dhëna dhe kontributin e juaj.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr. prot.02-060/01-0017151/25

Podujevë, datë: 27.03.2025

